



**VENDIM**

**Nr. 184, Datë 23.11.2016**

**MBI  
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETETEVE TË  
SHOQËRISË "ENERGAL" SH.P.K, NË FAVOR TË BANKËS  
"SOCIETE GENERALE ALBANIA"SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike, si dhe në zbatim të nenit 7; nenit 9 dhe nenit 10 të "Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licensuarit" të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016.; pikës 1.3 dhe 1.6 të "Licenses për Prodhimin e Energjisë Elektrike" gjithashtu dhe nenit 15 të "Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s", miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kërkesës së Shoqërisë "ENERGAL" sh.p.k, për lënie peng asetesh në favor të Bankës "Societe Generale Albania" sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

**Konstatoi se:**

- Shoqëria "ENERGAL" sh.p.k. nëpërmjet "Kontratë Kredie Bankare, Nr. 2337 Rep. dhe nr. 1313 Kol, datë 20.06.2016, ka lënë peng disa nga asetet e saj pranë "Raiffeissen Bank",
- Nëpërmjet "Deklaratë Noteriale" me Nr. 4174 Rep., Nr.2385 Kol., datë 22.09.2016 dhe Nr. 4177 Rep., Nr.2388 Kol., datë 22.09.2016, Raiffeissen Bank" sh.a., heq dorë nga pengun i vendosur në "Kontratën e Kredisë Bankare" të mësipërme.
- Shoqëria "ENERGAL" sh.p.k. ka aplikuar pranë ERE për të miratuar lënien peng të asetëve pranë Bankës "Societe Generale Albania" sh.a,
- Aplikimi i shoqërisë "ENERGAL" sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në "Rregulloren e procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit" si më poshtë:

**Neni 7, pika 1, gërmat: “a“** (ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); **“b“** (veprimtaria e licensuar); **“c“** (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); **“d“** (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); **“e“** (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); **“f“** (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); **“g“** (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licensuar); **“h“** (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); **“i“** (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licensuar pas kryerjes së transferimit); **“j“** (nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “ENERGAL”sh.p.k, për lënie peng të asetëve sipas listës bashkëlidhur në favor të Bankës ”Societe Generale Albania”sh.a.
2. Drejtoria e e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**

Lista për lënien peng të aseteve të Shoqërisë "ENERGAL"sh.p.k, në favor të Bankës "Societe Generale ALBANIA"sh.a. miratuar me Vendimin Nr. 184 datë 23.11.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E)

**Hec "Orgjost i ri" me fuqi 4800 KW,**

1. Gjenerator sinkron copë 2,
2. Valvol butterfly copë 2,
3. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
4. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
5. Transformator fuqie copë 2,
6. Qark 20 kV copë 2, Qark 6 kV copë 2,
7. Qark automatizimi copë 2,
8. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
9. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
10. Tubacione 623 m.

**N/st 20/110 kV,**

1. Transformator tensioni copë 2,
2. Konservues vaji copë 2,
3. Radiatorë me komponentët copë 2,
4. Depozita vaji copë 2,
5. Panele për transformatorët copë 2,
6. Mbrojtës mbitensioni copë 2,
7. Sisteme shtesë tap chenger copë 2,
8. Sewt shtesë mpass për transformatorë copë 2,
9. Sisteme tokëzimi disconnecter copë 2.